L I G J
Nr.7795, datë 16.2.1994

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7516, DATË 7.10.1991 "PËR SINDIKATAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.7516, datë 7.10.1991 "Për Sindikatat në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto ndryshime:

Neni 4 ndryshohet si vijon:

"Sindikatat krijohen me kërkesën e 300 punonjësve dhe regjistrohen në gjykatën e rrethit për sindikatat që funksionojnë në bazë rrethi. Kur sindikata e shtrin veprimtarinë e vet në disa rrethe, regjistrimi bëhet në gjykatën e rrethit ku sindikata ka selinë e saj. Për sindikatat që funksionojnë në bazë republike dhe për ato që funksionojnë në bazë dege, regjistrimi bëhet në gjykatën e rrethit të Tiranës.

Kërkesa për regjistrimin e një sindikate duhet të shoqërohet me origjinalin dhe me dy kopje të këtyre dokumenteve:

a) procesverbali i krijimit të sindikatës, i nënshkruar nga 300 anëtarë themelues;

b) statuti dhe programi i sindikatës.

Ndalohet përdorimi i emërtimeve të njëjta me organizatat sindikale që krijohen të reja, ose shkëputen nga grupimet sindikale ekzistuese".

Neni 6 shfuqizohet.

Neni 6/a ndryshohet si vijon:

"Çdo sindikatë duhet të paraqesë në gjykatën ku është regjistruar, 30 ditë pas regjistrimit të saj dhe në fund të çdo gjashtëmujori, dokumentin që vërteton derdhjen e kuotizacionit në bankë. Mosparaqitja e këtij dokumenti në afatin e caktuar automatikisht shkakton shpërndarjen e sindikatës".

Neni 22 ndryshohet si vijon:

"Gjykata ku është regjistruar sindikata, urdhëron çregjistrimin kur:

a) vëren shkeljet e parashikuara në nenin 21 të këtij ligji;

b) numri i anëtarëve të sindikatës ulet nën 300 veta;

c) personat juridikë ku ushtron veprimtarinë sindikata, mbyllen".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.785, datë 28.2.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha